

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	SHBA dhe Danimarka arrijnë marrëveshje për Groenlandën pas kërcënimeve të Trump për aneksim To p Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/shba-dhe-danimarka-arrijne-marreveshje-per-groenlanden-pas-kercenimeve-te-trump-per-aneksim/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 09:35:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 09:32:06 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	118f105e9ac5e769ede4319d8b26b2bb20ffe8b899fc8be38f9d5b57c14ec577
TEKSTI	3b86b5f770b903009e5f45f6a31fe0a6f5a246565f069f5da957bf0e4e432816
PAMJA	271d994d058fec22d484ca1ed37b58ffe8d5ee476388dc3d5404989dd711ffcc

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a62e81a55a43167f4d2a46c20deabf0338560db483244d2f0ad3bb07ca11508e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	34a49f1fb4e3ec12662634f6e1a4b8d33a530968e91968fa2be08bb537c32d65
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a62e81a55a43167f4d2a46c20deabf0338560db483244d2f0ad3bb07ca11508e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Bota

SHBA dhe Danimarka arrijnë marrëveshje për Groenlandën pas kërcënimeve të Trump për aneksim



Armelda Methasani

19 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Shtetet e Bashkuara dhe **Danimarka** kanë arritur një marrëveshje të re për sigurinë e Groenlandës, duke zbutur një përplasje diplomatike të krijuar pas kërcënimeve të presidentit amerikan Donald Trump për marrjen e territorit me forcë.

Marrëveshja u njoftua pas muajsh tensionesh, gjatë të cilave Trump ka argumentuar se Groenlanda ka një rëndësi strategjike për sigurinë kombëtare të SHBA-së, për shkak të pozicionit të saj në Arktik dhe pasurive të konsiderueshme minerare.

Trump deklaroi në një postim në rrjetin e tij social se marrëveshja do t'i japë SHBA-së "kontroll të përhershëm mbi sigurinë" e Groenlandës, si dhe mundësinë për të ndërmarrë masat që konsiderohen të nevojshme për mbrojtjen e territorit.

Sipas presidentit amerikan, marrëveshja parashikon gjithashtu që asnjë kundërshtar i SHBA-së të mos mund të mbajë prani ushtarake apo të kryejë investime të ndjeshme në Groenlandë pa miratimin e shprehur me shkrim nga Uashingtoni.

Danimarka: Respektohet sovraniteti i Groenlandës

Kryeministrja daneze Mette Frederiksen konfirmoi marrëveshjen dhe tha se ajo forcon sigurinë në Arktik dhe në zonën e Atlantikut të Veriut.

Frederiksen theksoi gjithashtu se marrëveshja njeh sovranitetin dhe integritetin territorial të Mbretërisë së Danimarkës, si dhe të drejtën e popullit të Groenlandës për vetëvendosje.

Sipas saj, dokumenti do të nënshkruhet në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara javën e ardhshme, por përpara hyrjes në fuqi do të duhet të kalojë procedurat e nevojshme parlamentare.

Edhe kreu i qeverisë së Groenlandës, Jens-Frederik Nielsen, e përshëndeti marrëveshjen, duke deklaruar se ajo forcon sigurinë e Groenlandës, Danimarkës dhe SHBA-së dhe një interesat e groenlandezëve.

Çfarë parashikon marrëveshja?

Teksti i plotë i marrëveshjes ende nuk është bërë publik. Megjithatë, një zyrtar i Departamentit amerikan të Shtetit ka dhënë disa detaje për përmbajtjen e saj.

Sipas zyrtarit, marrëveshja nuk do të skadojë edhe nëse Groenlanda do të bëhet shtet i pavarur në të ardhmen. SHBA-ja do të ketë gjithashtu të drejtë të ndërtojë struktura të reja ushtarake pa pasur nevojë për miratim paraprak nga Groenlanda apo Danimarka.

Marrëveshja parashikon, sipas të njëjtit burim, të drejta të përhershme për akses, bazim dhe fluturime ushtarake, ndërsa vendet jashtë NATO-s do të ndalohen të ndërtojnë baza ushtarake në territor.

Gjithashtu, synohet kufizimi i investimeve nga vende që konsiderohen kundërshtarë të SHBA-së, veçanërisht në sektorë strategjikë të ekonomisë groenlandeze. Zyrtari amerikan përmendi konkretisht Rusinë dhe Kinën.

Tensionet për Groenlandën

Marrëveshja vjen pas një periudhe të gjatë tensionesh mes Uashingtonit dhe Kopenhagës. Trump ka kërkuar prej muajsh që SHBA-ja të marrë kontrollin mbi Groenlandën, duke argumentuar se territori është i rëndësishëm për sigurinë amerikane dhe për kontrollin strategjik të Arktikut.

Deklaratat e tij, përfshirë kërcënimet për përdorimin e forcës ushtarake, shkaktuan reagime të forta në Danimarkë dhe në vende të tjera anëtare të NATO-s.

Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, e cilësoi marrëveshjen si “historike” dhe një arritje të rëndësishme për SHBA-në, duke thënë se ajo adreson në mënyrë të përhershme shqetësimet amerikane për sigurinë në Groenlandë.

Megjithatë, pa u bërë publik teksti zyrtar, mbeten pikëpyetje se sa ndryshon marrëveshja e re nga marrëveshjet ekzistuese mes SHBA-së dhe Danimarkës. Një marrëveshje e vitit 1951 i jep tashmë Uashingtonit të drejta të gjera për praninë ushtarake në Groenlandë.

SHBA-ja ka aktualisht më shumë se 100 ushtarakë të vendosur në mënyrë të përhershme në bazën Pituffik, në veriperëndim të Groenlandës.

Përtej rëndësisë së saj ushtarake, Groenlanda konsiderohet strategjike edhe për shkak të rezervave të mëdha, kryesisht të pashfrytëzuara, të mineraleve të rralla, të cilat përdoren në prodhimin e teknologjive moderne, përfshirë telefonat celularë dhe automjetet elektrike.

LAJME TË NGJASHME



Reagon SHBA pas vendimit të Hagës: Të shmanget retorika nxitëse...

1 MIN



Inxhinieri i DeepSeek: Nëse Anthropic kontrollon AI-në më të avancuar, pasojat mund të jenë si skenari i Hitlerit

2 MIN





Mesazhe të forta nga zyrtari i DASH, Lawton: Po punojmë me Shqipërinë për të goditur organizatat kriminale transnacionale

7 MIN



Presidenti kundërshton rregullat mbrojtëse për inteligjencën artificiale, Trump: Mos kini frikë nga AI

1 MIN



Kriza politike në Kosovë, reagon SHBA

1 MIN

MË TË LEXUARAT



"Nga traumat te dashuria..."/
Algert Sala zbulon nga buron
frymëzimi për këngët e tij: Kur
jam i mërzhitur...



Solli në jetë fëmijën e saj të parë
në mënyrë të fshehtë, ja se çfarë
nuk dini për "shtatzëninë" e
Lady Gaga-s!



Futbolli në zi, ndërron jetë
legjenda e Interit dhe Italisë



TRAGJIKE/Shuhet ish-lojtari i
NBA-së!



U hakmor duke.../Gruaja tregon
se si zbuloi mesazhet e të
dashurit me një tjetër!



Vranësira dhe reshje të dobëta, si
parashikohet moti sot në vend



Greqia forcon sigurinë në burgje,
3.7 milionë euro për skanerë dhe
sisteme kundër dronëve!



Nuk të vlerësoi kur ishe aty, por
do të të kërkojë kur të
largohesh... Përse ndodh kjo
gjë?!



Rruga Milot-Balldren/ 365 mln
euro nën hijen e SPAK, në
konsorciumin fitues edhe emra
në hetim nga Prokuroria e
Posaçme!



Ndahet nga jeta në moshën 103-
vjeçare Margarita Chant-
Papandreou, një pioniere e të
drejtave të grave në Greqi dhe
bashkëshortja e ish-kryeministrit
grek!


EDITORI SUGJERON



Nuk të vlerësoi kur ishe aty, por
do të të kërkojë kur të
largohesh... Përse ndodh kjo
gjë?!




"Njerëzit më njohin shumë
serioz, por..."/ Një tjetër emër
drejt BBV6? Artisti i njohur nuk
e përjashton mundësinë...



"TikTok-u ka dëmtuar
artistët..."/ Algert Sala: Tregu
muzikor është bërë shumë më i
vështirë! Shkëlqimi momental...



"Nga traumat te dashuria..."/
Algert Sala zbulon nga buron
frymëzimi për këngët e tij: Kur
jam i mërzhitur...



"Këngën e kisha bërë para katër
vitesh..."/ Algert Sala zbulon si
lindi bashkëpunimi me Inis
Nezirin për këngën "E imja"!





Xhelozit, flirt dhe më shumë vëmendje! Si zbulohet një dashuri e fshehtë?



Pa prisni, Maserati në bisedime me Huawei për dy modele të reja elektrike?!



Këto janë 5 ushqime që duhet t'i shmangni kur konsumoni kafe...



Electreon synon parkingjet me sistemin e ri të karikimit wireless!



3 përfitime të mundshme të probiotikëve që shkojnë përtej tretjes...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

Kontaktimi
Marketing
Frekuencat
Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for [tabnav](#) widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.